



ALBGAZ sh.a.
OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR
ZYRTARI I PËRPUTHSHMËRISË

Nr. _____ Prot

Tiranë, më 3.03.2026

RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË
2025

Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga ALBGAZ Sh.a.

ALBGAZ Sh.a
Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror
Njësia Administrative Nr. 5, Rruga e Kosovarëve,
Pallati Ndër Pro, Tiranë, Shqipëri
www.albgaz.al
NUIS: L71306034U



RAPORTI VJETOR I PËRPUTHSHMËRISË PËR VITIN 2025

**Mbi zbatimin e Programit të Përputhshmërisë në Sektorin e Gazit
Natyror nga ALBGaz Sh.a.**

Tiranë, 2026

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

Ky raport është përgatitur në bazë të informacionit që është vënë në dispozicion nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror ALBGAS Sh.a., Zyrtarit të Përputhshmërisë së Shoqërisë gjatë përmbushjes së përgjegjësisë së tij në vitin 2025.

Në zbatim të kërkesave të nenit 47, nenit 16 pika 7 të Ligjit 102/2015 datë 24.09.2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror", të ndryshuar, si dhe vendimit të ERE Nr. 345, datë 21.12.2022 "Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë. 16.08.2021 "për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAS sh.a" i ndryshuar, raporti vjetor do të publikohet në dy gjuhë në faqen zyrtare të internetit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Gazit - ALBGAS Sh.a (www.albgaz.al) brenda pesë ditëve nga paraqitja e tij në gjuhën shqipe Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Raporti duhet të ketë përfunduar deri më 31 mars të çdo viti.

Përgatiti:

Elvis Ponari MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë

Email: elvis.ponari@gmail.com

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

SHKURTIME DHE PËRKUFIZIME

ALBGAZ sh.a: Operatori i Kombinuar i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Nat.

ALBPETROL sh.a: Shoqëria publike e kërkimit Prodhimit të Naftës dhe Gazit

ERE: “Enti Rregullator i Energjisë”

OSSH/DSO: “Operator i Sistemit të Shpërndarjes”

ALBGAZ/TSO: “Operator i Sistemit të Transmetimit”

ENTSO-G: është Rrjeti European i Sistemit të Operatorëve të Transmetimit të Gazit (observer)

MIE: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

GNL: “Gaz Natyror i Lëngshëm”

MEDREG: Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut

ECRB: Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vëndeve të Komunitetit të Energjisë

ACER: Agjencia për kooperim e rregullatorëve të energjisë për Europën.

CEER: Këshilli European i Rregullatorëve të Energjisë

GRI SSE: Inisiativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug-Jug lindje

IGU: Unioni Ndërkombëtar i Gazit, jemi anëtarë me të drejta të plota

OME: Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë

UfM: Unioni për Mesdheun

ALPEX: Bursa Shqiptare të Energjisë.

PËRMBAJTJA

PJESA E PARË	6
1. HYRJE	6
2. MODELI ADMINISTRATIV	7
3. MISIONI I ALBGAZ	10
4. SHOQËRIA	12
5. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I ALBGAZ	13
6. PROGRAMI I PËRPUTHSHMËRISË	15
7. PAVARËSIA E ORGANEVE DREJTUESE ALBGAZ SH.A.	17
8. PËRJASHTIMI I SJELLJES DISKRIMINUESE	22
9. KONKURRENCA DHE MARREDHENIET KOMERCIALE	24
10. ZBATIMI I PARIMEVEVE	26
11. E DREJTA E INFORMIMIT	28
12. ZBATIMI I PROGRAMIT TE PAJTUESHMERISE	31
PJESA E DYTË	34
13. REKOMANDIMET E ZYRTARIT	34
14. BASHKËPUNIMI ME ERE-N	35
PJESA E TRETË	38
15. KONKLUZIONE	38

PJESA E PARË

1. HYRJE

Në mbështetje të ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, në zbatim të kërkesave të Programit të Përputhshmërisë është miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me Vendim Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë. 16.08.2021 “për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAS sh.a” i ndryshuar. Gjithashtu në mbështetje të nenit 21 të Direktivës 2009/72/EC e datës 13 Korrik 2009 “Mbi rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të energjisë që shfuqizon Direktivën 2003/54/EC” u hartua ky raport.

Raporti vjetor u hartua në bazë të detyrave të Zyrtarit të Përputhshmërisë, Z. Elvis Ponari MBA, MSc (Zyrtari), miratuar me Vendimin paraprak ERE Nr. 355, datë 28.12.2022 “Mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së Albgaz sh.a dhe vendimi nr. 3 datë 01.02.2023 nga Këshilli Mbikëqyrës i Albgaz sh.a “Emërimin e zyrtarit të përputhshmërisë të shoqërisë Albgaz Sh.a”. Ky raport vjetor i Përputhshmërisë që hartohet për herë të pestë si pjesë e kompetencave ligjore të aktivitetit të Zyrtarit të shoqërisë “ALBGAS” sh.a. (ALBGAS) në lidhje me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë, ka synuar të prezantojë mekanizmin për zbatimin e këtij Programi, përcaktimin e detyrave funksionale dhe detyrimeve të punonjësve të ALBGAS në lidhje me këtë Program, duke u mbështetur në monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtij Programi. Ky raport është një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e performancës së ALBGAS dhe transparencës së operacioneve të saj, duke mundësuar një pasqyrë të qartë dhe të besueshme për të gjithë palet e interesuara.

Në këtë raport vjetor përputhshmërie parashtrohet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit sipas Programit të Përputhshmërisë të miratuar për herë të parë në 2020 nga Këshilli Mbikëqyrës i ALBGAS me vendim Nr.18, datë 04.11.2020 mbi “miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”, miratuar në ERE me vendim nr. 263, datë 28.12.2020. “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a”. Ky raport paraqet një pasqyrë të detajuar të angazhimeve dhe përmbushjes së kërkesave ligjore dhe rregullatore nga ana e shoqërisë, në përputhje me standardet dhe politikat kombëtare të gazit.

Programi nxjerr një Raport vjetor, i cili bazohet në sigurimin e shmangies së sjelljeve diskriminuese të ALBGAS ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror dhe përdoruesve të rrjetit, pavarësisë së ALBGAS, konfidencialitetin e të gjithë informacionit të menaxhuar nga **ALBGAS si dhe transparencës së procedurave të ndjekura prej saj përgjatë periudhës 1.1.2025 – 31.12.2025.**

Zyrtari konstantoi që ALBGAS është në përputhje me standartet e industrisë, ligjet, rregullat dhe rregulloret e përcaktuara nga ERE. Zyrtari gjatë vitit 2025 e analizoj kompaninë sipas Programit dhe ushtroi detyrën e tij që Programi të zbatohet nga shoqëria. Gjithashtu përgjatë 2025 Zyrtari është kujdesur që kompani të respektoj dhe rregulloret ndërkombëtare. Për të përmbushur çdo kërkesë për përputhshmërinë, Zyrtari sëbashku me ALBGAS kanë bashkëpunuar për të krijuar

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

rregullore, udhëzime, trajnime, prezantime, dhe procese në mënyrë aktive në mënyrë që shoqëria dhe stafi i saj të jetë sa më në përputhshmëri me Programin.

Shoqëria ALBGAS sh.a. është person juridik shqiptar, e krijuar nga aksionari i vetëm MIE, bazuar në nenin 3, pika 1, të ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), në formën ligjore të shoqërisë aksionare, me ofertë private, bazuar në nenin 103 të ligjit nr. 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, në korrespondencën dhe aktet e shoqërisë, përfshirë të gjitha shkresat, formularët e urdhrave, çdo publikim, të nxjerra nëpërmjet shkrimit apo formës elektronike që u adresohen palëve të treta, emri/emërtimi i Shoqërisë përmban të dhënat e mëposhtme:

- a. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS): L71306034U;
- b. Emri i Subjektit: ALBGAS sh.a;
- c. Data e themelimit: 7.12.2016;
- d. Forma ligjore përshkruar me fjalë : Shoqëri Aksionare ose Sh.A.;
- e. Seline e saj; të dhëna nëse Shoqëria është në likuidim dhe vlera e kapitalit të regjistruar e shlyer;
- f. Zyrat qendrore e shoqërisë në Shqipëri, Rr. e Kosovareve, Njësia Administrative Nr. 5, Pallati Ndër Pro, Tiranë

2. MODELI ADMINISTRATIV

Modeli Administrativ i ALBGAS Sh.a. përbën bazën e organizimit të brendshëm, drejtimit strategjik dhe kontrollit të zbatimit të kërkesave ligjore dhe rregullore në sektorin e gazit natyror. Ky model është ndërtuar në përputhje me Ligjin nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore dhe vendimet e Entit Rregullator të Energjisë (ERE). Struktura organizative e ALBGAS garanton ndarjen e qartë të funksioneve vendimmarrëse, administrative dhe mbikëqyrëse, duke siguruar zbatimin e parimit të ndarjes dhe pavarësisë që kërkohet nga legjislacioni për operatorët e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.

2.1 Asambleja e Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë ALBGAS Sh.a.. Ajo përbëhet nga aksionari i vetëm, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e cila ushtron të gjitha të drejtat që burojnë nga zotërimi i 100% të aksioneve të shoqërisë.

Pa paragjykuar kompetencat e tjera të përcaktuara nga Ligji dhe Statuti, Asambleja e Përgjithshme:

- Miraton politikat e përgjithshme tregtare dhe strategjinë e zhvillimit të shoqërisë në sektorin e gazit natyror;
- Miraton planet financiare vjetore dhe afatmesme, si dhe çdo ndryshim të tyre;
- Emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit të Administrimit;
- Miraton pasqyrat financiare vjetore, raportet e veprimtarisë dhe shpërndarjen e fitimeve;
- Vendos për rritjen ose uljen e kapitalit aksionar;

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

- Vendos për krijimin e filialeve të reja, bashkëpunimeve strategjike, si dhe për ndryshime të tjera strukturore në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Merr vendime lidhur me investimet strategjike për zhvillimin e rrjetit kombëtar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit;
- Miraton ndryshimet statutores dhe rregullat e funksionimit të shoqërisë;
- Jep udhëzime për strukturën organizative, numrin e përgjithshëm të punonjësve, nivelet e pagave dhe politikat e burimeve njerëzore.

Vendimet e Asamblesë janë të detyrueshme për të gjitha organet e tjera të ALBGAS Sh.a. dhe formojnë kornizën e përgjithshme në të cilën shoqëria zhvillon aktivitetin e vet në përputhje me legjislacionin e sektorit të gazit.

2.2 Këshilli i Administrimit

Këshilli i Administrimit është organi mbikëqyrës dhe drejtues i ALBGAS Sh.a., përgjegjës për orientimin strategjik, mbikëqyrjen e veprimtarisë ekonomiko-financiare dhe sigurimin e përputhshmërisë ligjore dhe rregullatore të shoqërisë.

Këshilli përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Anëtarët janë profesionistë me eksperiencë në fusha të tilla si: ekonomi, drejtësi, inxhinieri energjetike dhe menaxhim, në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin tregtar dhe legjislacionin sektorial për gazin natyror.

Detyrat kryesore të Këshillit të Administrimit përfshijnë:

- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare dhe planeve të miratuara nga Asambleja;
- Dhënien e direktivave për Administratorin në lidhje me zbatimin e strategjisë së shoqërisë;
- Sigurimin e respektimit të kërkesave ligjore dhe rregullatore në çdo aktivitet të shoqërisë;
- Kontrollin e pasqyrave financiare dhe miratimin e raporteve vjetore;
- Mbikëqyrjen e implementimit të investimeve strategjike për rrjetin e gazit natyror;
- Sigurimin e funksionimit të brendshëm në përputhje me parimet e ndarjes ligjore dhe funksionale;
- Sigurimin që çdo vendimarrje të jetë në interes publik, pa diskriminim dhe me transparencë për të gjithë pjesëmarrësit në treg.

Këshilli i Administrimit mban mbledhje periodike, zakonisht një herë në muaj, dhe gjithashtu mbledhje të jashtëzakonshme në raste kur kërkohet për shkak të zhvillimeve strategjike, ndryshimeve ligjore ose kërkesave të ERE-së.

Këshilli i Administrimit ka kompetence:

- a) të japë direktiva për administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;
- c) të përgatisë me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- 9) të therrë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- d) të kujdeset që Shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- dh) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabel, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;

Zyrtari i Përputhshmërisë , ALBGAS SH.A.

Faqe 8

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

- e) te siguroje se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurise se veprimtarise, si dhe detyrimet e tjera te raportimit e publikimit, te detyrueshme ne baze te ligjit apo statutit, te kryhen me saktësi nga Administratori. Keto dokumente duhet te miratohen e te nenshkruhen nga te gjithë anetaret e Keshillit te Administrimit per t'i paraqitur Asamblese se Pergjithshme, se bashku me nje raport te Keshillit te Administrimit per miratim edhe nje pershkrim per mbikeqyrjen e menaxhimit gjate gjithë vitit financiar;
- e) te siguroje se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabel te kryhet te pakten nje here ne vit auditues ligjor i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblese se Pergjithshme, t'u vendoset ne dispozicion te gjithë anetareve te Keshillit dhe Administratorit. Raporti i Keshillit te Administrimit, permendur ne piken e), duhet te permbaje edhe mendimin per raportin e auditimit;
- f) t'i propozoje Asamblese se Pergjithshme shkarkimin / lirimin e Administratorit;
- g) te percaktoje shperblimin e Administratorit;
- gj) te miratoje marrjen persiper te detyrimeve me vlere me te larte se 5 perqind te aseteteve te Shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiar_e, te 9ertifikuara, nepermjet nenshkrimet te huave apo emetimit te obligacioneve apo instrumenteve te tjera te borxhit;
- h) te vendose krijimin e bashkepunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, per themelimin e shoqerive tregtare ose te grupeve te reja;
- i) te miratoje ndryshimet nga plani i miratuar per furnizimin me mallra, sherbime apo shpenzime te tjera;
- j) te kryeje veprimet e tjera, te percaktuara ne ligj dhe ne Statut; Keshilli i Administrimit ka detyrimet e parashikuara ne Statut dhe nenin 163 te ligjit nr. 9901/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

2.3 Administratori

Administratori është organi ekzekutiv i ALBGAS Sh.a. dhe përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit të Administrimit. Ai vepron si përfaqësues ligjor i shoqërisë dhe ka mandat 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Detyrat kryesore të Administratorit janë:

- Zbatimi i strategjive, politikave dhe planeve të miratuara nga organet drejtuese;
- Përfaqësimi i shoqërisë përpara institucioneve shtetërore, rregullatore dhe aktorëve të tregut;
- Menaxhimi i burimeve financiare, njerëzore dhe teknike të shoqërisë në përputhje me ligjin dhe vendimet e Këshillit;
- Përgatitja e bilancit vjetor dhe raporteve ekonomiko-financiare për miratim;
- Sigurimi i funksionimit efikas të rrjetit kombëtar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror;
- Zbatimi i detyrimeve që burojnë nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi, përfshirë rregulloret e ERE-së dhe direktivat evropiane;
- Raportimi i rregullt tek Këshilli i Administrimit për ecurinë e operacioneve dhe për çdo çështje me rëndësi strategjike ose rregullatore.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

- Administratori është përgjegjës që aktiviteti i përditshëm të jetë në përputhje të plotë me Programin e Përputhshmërisë dhe parimet e mosdiskriminimit, transparencës dhe ndarjes ligjore të kërkuara nga legjislacioni për gazin natyror.

3. MISIONI I ALBGAZ

Shoqëria ALBGAZ Sh.a. është operatori i kombinuar i sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në Republikën e Shqipërisë. Si një shoqëri aksionare me zotërim të plotë shtetëror, ajo vepron në përputhje me ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe është përgjegjëse për ndërtimin, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës kombëtare të gazit natyror në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

3.1 Qëllimi Strategjik

Misioni i ALBGAZ është të sigurojë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe të hapur të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, duke:

- Mundësuar akses të barabartë, të paanshëm dhe transparent në rrjet për të gjithë përdoruesit e interesuar;
- Garantuar shërbime me cilësi të lartë, në përputhje me treguesit teknikë të përcaktuar nga rregulloret dhe ligji;
- Ndihmuar në zhvillimin e tregut kombëtar të gazit natyror, duke kontribuar në diversifikimin e burimeve të energjisë dhe integrimin në tregjet rajonale dhe evropiane;
- Promovuar përdorimin e gazit si burim energjie efikas dhe me ndikim të reduktuar mjedisor, në përputhje me objektivat kombëtare të tranzicionit energjetik.

3.2 Fusha e Veprimtarisë

Në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, ALBGAZ është përgjegjëse për:

- Transmetimin e gazit natyror nëpërmjet sistemit kombëtar të tubacioneve, duke garantuar siguri operative dhe standarde të larta teknike;
- Shpërndarjen e gazit natyror nëpërmjet rrjeteve lokale dhe rajonale të shpërndarjes;
- Sigurimin e qasjes jodiskriminuese në rrjet për të gjithë përdoruesit dhe pjesëmarrësit në treg, në përputhje me rregullat për akses të rregulluar dhe tarifat e miratuara nga ERE;
- Planifikimin dhe zhvillimin e rrjeteve të reja të transmetimit dhe shpërndarjes, në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe kërkesat e tregut të gazit;
- Mirëmbajtjen dhe modernizimin e vazhdueshëm të infrastrukturës ekzistuese për të siguruar cilësi dhe siguri maksimale të furnizimit;
- Zbatimin e standardeve të sigurisë teknike dhe mjedisore, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe direktivat evropiane.

3.3 Parimet Themelore të Veprimtarisë

Veprimtaria e ALBGAZ udhëhiqet nga një sërë parimesh bazë të përcaktuara nga legjislacioni për sektorin e gazit natyror dhe standardet e Bashkimit Evropian:

- Pavarësia dhe ndarja ligjore/funksionale e operatorit nga çdo aktivitet tjetër konkurrues në sektorin e energjisë;

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

- Mosdiskriminimi ndaj përdoruesve të rrjetit, duke siguruar kushte të barabarta për të gjithë operatorët dhe furnizuesit e tregut;
- Transparenca në ofrimin e shërbimeve dhe publikimin e informacionit të nevojshëm për pjesëmarrësit në treg;
- Konfidencialiteti i informacionit tregtar, në mënyrë që të mbrohen të dhënat e ndjeshme të përdoruesve dhe pjesëmarrësve në treg;
- Efikasiteti operacional dhe përdorimi racional i burimeve, në përputhje me parimet e menaxhimit të mirë ekonomik;
- Siguria dhe qëndrueshmëria afatgjatë e sistemit të gazit natyror.

ALBGASZ në përputhje me objektin e veprimtarisë së themelimit dhe më pas liçensimit të saj, i cili është zhvillimi dhe operimi i infrastrukturës së transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri, ku krahas oportuniteteve që paraqet realizimi i objektit të veprimtarisë, përballet me disa sfida kryesore duke përfshirë por pa u kufizuar në:

Bashkëpunimi me investitorë të huaj për të zhvilluar rrjetin e gazit në zona të caktuara brenda territorit të Vendit.

Përmirësimi i infrastrukturës aktuale të gazit natyror në Shqipëri, e cila është tejte e amortizuar, rehabilitimi i të cilës kërkon investime të konsiderueshme;

Ngritja dhe zhvillimi i rrjetit të interkonjeksionit me vendet e rajonit;

ALBGASZ, që nga momenti i krijimit, mori barrën e zhvillimit të mëtejshëm të proceseve në përputhje me objektivat dhe strategjitë e përcaktuara, kështu që një nga detyrimet ishte edhe përmirësimi i angazhimeve ndaj shoqërisë TAP AG. Për këtë qëllim, u krijua shoqëria AGSCO - "Albanian Gas Service Company" SHA me objekt të veprimtarisë realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së gazsjellësit TAP AG. Kjo u bë e mundur nëpërmjet partneritetit me shoqërinë italiane SNAM S.p.A, një shoqëri lider në fushën e infrastrukturës së gazit natyror dhe njëkohësisht aksionar i shoqërisë TAP AG. Gjithashtu, në funksion të realizimit të detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjen e Mirëmbajtjes, janë financuar nga TAP AG dhe realizuar nga ALBGASZ, Qendra e Mirëmbajtjes në Korçë dhe Qendra e Mirëmbajtjes në FIER. **TË DYJA KËTO QENDRA TASHMË FUNKSIONOJNË NË PËRPUTHJE ME STANDARTET MË TË LARTA TË SEKTORIT TË PËRCAKTUARA NGA ANA E TAP.** ALBGASZ është aksionari mazhoritar në Shoqërinë AGSCO - "Albanian Gas Service Company" SHA, zotërues i 75% të aksioneve dhe rrjedhimisht përfitues nga fitimet e shpërndara çdo vit në formën e dividendit duke zbutur dhe ndikuar në bilancin e shoqërisë.

Në përputhje me kushtet e tregut, ALBGASZ ka pasur si klient të vetëm për ofrimin e shërbimit të transmetimit të gazit natyror shoqërinë Albpetrol sh.a, e cila duke filluar me pandeminë COVID-19 uli në mënyrë të ndjeshme prodhimin e naftës dhe rrjedhimisht edhe sasinë e gazit shoqëruar për transmetim, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe të ardhurat nga ky aktivitet. Në vijim dhe për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2025 shoqëria ALBGASZ nuk ka pasur aktivitet në transmetimin e Gazit Natyror. Megjithatë, Albpetrol ka vijuar të mbajë në funksion dhe gadishmeri linjat e transmetimit për nevojat e Albpetrol në të ardhmen.

3.4 Roli në Kontekstin Kombëtar dhe Rajonal

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

ALBGAZ luan një rol të rëndësishëm në procesin e gazifikimit të Shqipërisë dhe integrimin e sistemit kombëtar në rrjetet rajonale dhe evropiane të gazit. Kompania është pjesë aktive e iniciativave ndërkombëtare si ENTSO (Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të Gazit) në statusin e “observer” dhe bashkëpunon ngushtë me institucionet e Bashkimit Evropian, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe operatorët homologë të vendeve fqinje.

Përmes këtyre bashkëpunimeve, ALBGAZ kontribuon në:

- Rritjen e sigurisë së furnizimit me gaz për vendin dhe rajonin;
- Zhvillimin e tregjeve të ndërlidhura të energjisë;
- Krijimin e një infrastrukture që mbështet objektivat e tranzicionit energjetik dhe zhvillimit të qëndrueshëm;
- Nxitjen e konkurrencës dhe përmirësimin e efikasitetit në sektorin e gazit natyror.

4. SHOQËRIA

ALBGAZ Sh.a. është një shoqëri aksionare me zotërim të plotë shtetëror, themeluar me Vendimin nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë ALBGAZ Sh.a.”.

Shoqëria është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS L71306034U dhe është nën administrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) si aksionari i vetëm.

4.1 Objektet e Veprimtarisë

Objekti kryesor i veprimtarisë së ALBGAZ është:

- Transmetimi i gazit natyror në territorin e Republikës së Shqipërisë përmes rrjetit kombëtar të tubacioneve;
- Shpërndarja e gazit natyror për përdoruesit fundorë përmes rrjeteve lokale dhe rajonale;
- Ndërtimi, operimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i infrastrukturës së gazit natyror, në përputhje me standardet teknike dhe mjedisore të BE-së;
- Sigurimi i kushteve për qasjen jodiskriminuese të palëve të treta në sistem, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe direktivat evropiane;
- Zbatimi i programeve të zhvillimit të sektorit të gazit, përfshirë projektet strategjike të gazifikimit, zgjerimin e rrjetit dhe ndërlidhjen me rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare.

4.2 Struktura Organizative

Shoqëria është e organizuar në mënyrë që të sigurojë:

- Ndarje të qartë të funksioneve vendimmarrëse dhe ekzekutive, sipas kërkesave të Ligjit nr. 102/2015;
- Pavarësi të plotë të strukturave teknike dhe operative, në mënyrë që të garantohet funksionimi i sistemit të gazit në mënyrë neutrale dhe të paanshme;
- Zbatim efektiv të Programit të Përputhshmërisë, përmes Zyrtarit të Përputhshmërisë dhe mekanizmave të brendshëm të kontrollit;
- Funksionimin e departamenteve të specializuara për: operimin teknik të rrjetit, planifikimin dhe investimet, marrëdhëniet me rregullatorin, zhvillimin e tregut dhe shërbimet mbështetëse.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

- Në zbatim të kërkesave ligjore, ALBGAZ ka përcaktuar rregulla të brendshme për aksesin në informacion, për konfidencialitetin e të dhënave tregtare, dhe për ndarjen funksionale të stafit nga çdo aktivitet potencialisht konkurrues në sektorin e energjisë.

4.3 Selia dhe Infrastrukturat Kryesore

- Selia qendrore: Rr. e Kosovarëve, Njësia Administrative Nr. 5, Pallati Ndër Pro, Tiranë
- Njësia operationale në Fier: përdoret për koordinimin e aktiviteteve teknike të rrjetit të shpërndarjes dhe operacionet në terren
- Pika të rëndësishme infrastrukturore: lidhje me sistemet ekzistuese të transmetimit ndërkombëtar (TAP) dhe me rrjetet e shpërndarjes në zhvillim.

Shoqëria ndodhet në një fazë të rëndësishme të zhvillimit të sistemit kombëtar të gazit natyror, me theks të veçantë tek ndërtimi i rrjeteve të reja, integrimi me sistemet ndërkombëtare dhe përgatitja për funksionimin e plotë të tregut të gazit në përputhje me direktivat e BE-së.

ALBGAZ është një shoqëri aksionare me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti me aksionar të vetëm Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), e krijuar me Vendimin Nr. 848, datë 7.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës. Gjithashtu shoqëria ka një zyrë përfaqësimi në qytetin e Fierit.

Përgjatë kësaj periudhe, ALBGAZ i ka bërë me dije Entit Rregullator të Energjisë se ka marrë të gjitha masat dhe aktualisht jemi në proces konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimarrje. Gjithashtu, duhet theksuar se shoqëria është në një fazë të rëndësishme të zhvillimit të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, në të cilën MIE ka një rol kyç jo vetëm si institucioni përgjegjës për politikën e zhvillimit të sektorit të gazit natyror, por edhe të mbikëqyrjes së ecurisë së projekteve të zhvillimit dhe të ndërtimit të sistemit të ri të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në vend, në pozitën e pronarit të aksioneve të shoqërisë ALBGAZ.

Kjo vendimarrje është përtej kompetencave administrative të shoqërisë pasi ka të bëjë me politikën bërjen e veprimtarisë tregtare.

5. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I ALBGAZ

Viti 2025 ka qenë një periudhë kyçe për zhvillimin e sektorit të gazit natyror në Shqipëri dhe për forcimin e pozitës institucionale dhe operative të ALBGAZ Sh.a. në tregun kombëtar dhe rajonal të energjisë.

Gjatë këtij viti janë miratuar disa akte nënligjore dhe vendime të rëndësishme të Bordit të ERE-së, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në aktivitetin e shoqërisë dhe në implementimin e Programit të Përputhshmërisë.

5.1 Vendime dhe Akte të Reja Rregullatore

Gjatë vitit 2025, Bordi i ERE-së ka miratuar ndër të tjera:

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

- Vendimi nr. 310, datë 12.12.2025 – MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË ALBGAS SH.A. PËR SHTYRJEN E PROCEDURËS SË MIRATIMIT TË PLANIT DHJETËVJEÇAR TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT;
- Vendimi nr. 313, datë 12.12.2025 – mbi LËNIEN NË FUQI PËR VITIN 2026 TË TARIFËS SË PËRKOSSHME TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGAS” SH.A. MIRATUAR VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 206, DATË 16.12.2019,

Këto vendime kanë krijuar kornizën rregullore të re brenda së cilës ALBGAS ka detyrimin të përshtasë strukturën e vet organizative, të përditësojë procedurat e brendshme dhe të përmbushë të gjitha kërkesat e Programit të Përputhshmërisë. Bordi i ERE -s vendosi mbi një ndryshim në vendimin e : Shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s për vitin 2026, deri në miratimin e një tarife të mbështetur në aplikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “Albgaz” sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 17, pika “e” të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

5.2 Projekte Strategjike

Gjatë vitit 2025 në vëndin tone kanë ushtruar aktivitet TAP AG dhe Albgaz sh.a.

Faktikisht ne jemi përgatitur për hapjen e tregut të gazit dhe për këtë kemi:

- Të gjitha aktet nënligjore të domosdoshme për të ushtruar hapjen e tregut
- Janë përgatitur një sërë projektesh të gatshme të cilat presin sa më parë aplikimin e tyre
- Kemi adoptuar të gjitha Direktivat dhe Rregulloret e Bashkimit Europian
- Marim vendime të përbashkëta me autoritetet e Italisë dhe Greqisë në lidhje me aktivitetin e TAP.
- Jemi pjesë e të gjitha Institucioneve dhe Shoqatave të Gazit në Europë, Rajon dhe në Botë, jemi bashkëautorë në studime duke qënë koherentë për situatën e gazit.
- Është bërë një punë jashtëzakonisht e mire për hapjen e tregut të gazit me projekte prioritare dhe në vazhdimësi dhe konkretisht:
 - a. Projekti i gazifikimit të qytetit të Korçës, është gati për të startuar së bashku me kompaninë kombëtare SOCAR të Azerbajxhanit dhe do të jetë hapi i parë për të shtrirë vazhdimin e projekteve të shpërndarjes në të gjithë vëndin tonë.
 - b. Projekti i TEC-it Roskovec, 170 MW
 - c. Tubacioni Terminalit Vlorë-TEC Vlorë
 - d. Projekti i detajuar Fier-Vlorë-Fier (Interkoneksioni me TAP)
 - e. Ionian Adriatik Pipelinë (IAP), seksioni Fier-Kashar, i cili do të jetë fillimi i tubacionit për rajonin por që do të gazifikojë Tiranën dhe Durrësin.
 - f. Projekti i depozitimit nëntoksor të gazit në Dumre, për momentin është i stopuar por ka një marrëveshje me kompaninë SNAM për ta zhvilluar atë.
 - g. Projekti i terminalit të LNG-së në Vlorë.Për momentin është i stopuar, pritet të zhvillohet nga kompanitë amerikane.
 - h. Projekti i tubacionit të lidhjes me Kosovën, ALKOGAP
 - i. Projekti i tubacionit të lidhjes me Maqedoninë e Veriut.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

Të gjitha këto janë në koherencë të plotë me Direktivat dhe Rregulloret e gazit të Bashkimit Evropian. Theksojmë gjithashtu se këto Direktiva dhe Rregullore kanë afatin e zbatimit për ne sipas Sekretariatit të Energjisë në Vienë.

Për të gjithë vendet candidate për në Bashkimin Evropian, Sekretariati Energjisë jep një ndihmë të jashtëzakonshme për mbështetjen dhe aplikimin e tyre në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror.

5.3 Marrëdhëniet Institucionale

ALBGAZ ka forcuar bashkëpunimin institucional me:

- Entin Rregullator të Energjisë (ERE), për zbatimin e programeve rregullatore dhe procedurave të raportimit;
- Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si aksionarin e vetëm dhe si autoritet përgjegjës për politikën sektoriale;
- Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe ENTSOG, për përafrimin me standardet dhe praktikën evropiane;
- Operatorët dhe aktorët privatë të tregut, për të siguruar një mjedis konkurrues, transparent dhe të qëndrueshëm në sektorin e gazit natyror.

6. PROGRAMI I PËRPUTHSHMËRISË

6.1 Dispozita të Përgjithshme

Programi i Përputhshmërisë i ALBGAZ Sh.a. është dokumenti bazë që përcakton rregullat, procedurat dhe masat organizative për të siguruar që shoqëria:

- Të veprojë në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar dhe direktivat e BE-së për sektorin e gazit natyror;
- Të garantojë pavarësinë ligjore dhe funksionale nga çdo aktivitet tjetër konkurrues në tregun e energjisë;
- Të sigurojë akses të barabartë dhe të pandikuara politikisht apo tregtarisht në sistemet e transmetimit dhe shpërndarjes për të gjithë palët e interesuara;
- Të parandalojë çdo formë diskriminimi në ofrimin e shërbimeve të rrjetit;
- Të mbrojë konfidencialitetin e informacionit tregtar të pjesëmarrësve në treg, në përputhje me nenin 49 të Ligjit nr. 102/2015.
- Programi është miratuar nga Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) dhe është i detyrueshëm për të gjitha strukturat organizative të ALBGAZ Sh.a. Ai zbatohet në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerësohet çdo vit nga Zyrtari i Përputhshmërisë, në bashkëpunim me strukturat e brendshme dhe organet rregullatore.

6.2 Raportimi i Zbatimit të Programit

Në përputhje me nenin 47 të Ligjit nr. 102/2015, Zyrtari i Përputhshmërisë është i detyruar të raportojë çdo vit tek ERE për:

- Ecurinë e zbatimit të Programit të Përputhshmërisë;
- Masat organizative dhe ligjore të ndërmarra për garantimin e pavarësisë;

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

- Çdo rast të mundshëm të shkeljeve ose mospërputhjeve të konstatuara gjatë vitit;
- Rekomandimet për përmirësime në strukturë, procedura apo rregullore të brendshme.

Gjatë vitit 2025:

- Nuk janë konstatuar raste shkeljesh materiale të Programit të Përputhshmërisë;
- Është zhvilluar një proces i rregullt monitorimi i brendshëm, në bashkëpunim me drejtuesit e departamenteve operative dhe ligjore;
- Janë identifikuar fusha që kërkojnë përmirësim, kryesisht në drejtim të përditësimit të procedurave të brendshme dhe përforcimit të komunikimit ndërdepartamental për çështjet e përputhshmërisë;
- Është përgatitur dhe dorëzuar në afat raporti vjetor tek ERE dhe është publikuar në faqen zyrtare të shoqërisë në përputhje me afatet ligjore.

6.3 Vlerësime nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka mbështetur Shqipërinë në procesin e certifikimit të ALBGAS Sh.a. si Operator i Sistemit të Transmetimit të gazit natyror.

Në raportet e tij të fundit vjetore, Sekretariati ka vlerësuar:

- Progresin e Shqipërisë në transpozimin e plotë të acquis të gazit;
- Përpunimin e ALBGAS në përgatitjen për certifikim sipas modelit të ndarjes ligjore dhe funksionale;
- Nevojën për përshpejtimin e disa reformave të brendshme, kryesisht në fushën statutores dhe në zbatimin praktik të ndarjes funksionale.
- Këto vlerësime janë marrë në konsideratë në hartimin e planit të veprimit të ALBGAS për vitin 2026, me qëllim finalizimin e plotë të certifikimit dhe forcimin e pavarësisë operacionale të shoqërisë.

6.4 Koordinimi i Projekteve Strategjike të Gazifikimit

ALBGAS ka një rol kyç në koordinimin dhe zbatimin e projekteve strategjike të gazifikimit, të cilat janë pjesë integrale e planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të sistemit kombëtar të gazit natyror.

ALBGAS informon që projektet e gazifikimit janë në proces shqyrtimi nga Bordi i ERE.

Gjatë vitit 2025 janë ndërmarrë hapa konkretë për:

- Zgjerimin e rrjetit kombëtar të transmetimit drejt zonave industriale dhe urbane;
- Ndërtimin e segmenteve të reja të rrjetit të shpërndarjes në bashkëpunim me bashkitë dhe operatorët lokalë;
- Lidhjen me rrjetet ndërkombëtare përmes TAP dhe projekteve të interkoneksioneve rajonale;
- Hartimin e planeve të investimeve në përputhje me kërkesat e rregullores së ERE për planifikimin dhjetëvjeçar.
- Koordinimi i këtyre projekteve është i lidhur ngushtë me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë, pasi çdo investim strategjik duhet të respektojë parimet e mosdiskriminimit dhe aksesit të barabartë në rrjet për të gjitha palët e interesuara.

ALBGAS informon që projektet e gazifikimit janë në proces shqyrtimi nga Bordi i ERE.

Zyrtari i Përputhshmërisë, ALBGAS SH.A.

6.5 Detyrat e Zyrtarit të Përputhshmërisë

Në përputhje me vendimin përkatës të Bordit të ERE-së dhe legjislacionin në fuqi, Zyrtari i Përputhshmërisë i ALBGAS është përgjegjës për:

- Mbikëqyrjen e zbatimit të Programit të Përputhshmërisë nga të gjitha strukturat e kompanisë;
- Verifikimin e pavarësisë organizative, vendimmarrëse dhe operacionale;
- Sigurimin e aksesit të barabartë dhe mosdiskriminues për të gjithë përdoruesit e rrjetit;
- Kontrollin e respektimit të rregullave për konfidencialitetin e informacionit tregtar;
- Raportimin vjetor pranë ERE-së dhe publikimin e raportit në faqen zyrtare të shoqërisë;
- Rekomandimin e masave për përmirësim të procedurave të brendshme dhe ndërtimin e një kulture të përputhshmërisë në të gjitha nivelet e organizatës.
- Zyrtari ka ushtruar detyrat e tij në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, duke pasur akses në të gjitha dokumentet dhe informacionet e nevojshme për të kryer funksionet e tij në mënyrë efektive.

7. PAVARËSIA E ORGANEVE DREJTUESE ALBGAS SH.A.

Në këtë Raport Vjetor të Përputhshmërisë, paraqitet monitorimi dhe mbarëvajtja e procesit të zbatimit të Programit të Përputhshmërisë për periudhën raportuese.

Kërkesat dhe parimet rregullatore të përcaktuara nga kuadri ligjor kombëtar dhe direktivat evropiane për sektorin e gazit natyror përbëjnë prioritet për ALBGAS Sh.a., dhe çdo strukturë e saj është e detyrueshme t'i zbatojë dhe të garantojë përputhshmërinë me to në të gjitha nivelet e veprimtarisë.

Në përputhje me Ligjin Nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, ALBGAS ka ndërmarrë një proces të plotë ndarjeje ligjore, funksionale dhe financiare, në mënyrë që aktivitetet e saj si Operator i Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes së Gazit Natyror të jenë të pavarura nga çdo aktivitet tjetër i licencuar brenda grupit.

Ky proces garanton që ALBGAS të funksionojë si shoqëri e pavarur dhe të përmbushë kërkesat ligjore për pavarësinë operacionale, integritetin e tregut dhe trajtimin e barabartë të të gjithë përdoruesve të rrjetit.

Pavarësia e ALBGAS është e garantuar nga dispozitat e ligjit dhe statutit të shoqërisë, të cilat përcaktojnë se ALBGAS ka:

- të drejta të plota vendimmarrëse në lidhje me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të gazit;
- autonomi të plotë nga shoqëria mëmë për aktivitetet e përditshme operative;
- strukturë të veçantë organizative dhe menaxheriale, të ndarë nga çdo aktivitet tjetër tregtar.

Ky sistem i pavarur operativ është thelbësor për të siguruar integritetin dhe efikasitetin e funksionimit të sistemit të gazit, si dhe për të respektuar kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

Marrëdhënia me Shoqërinë Vertikalisht të Integruar

Marrëdhënia ndërmjet ALBGAS Sh.a. dhe shoqërisë mëmë (vertikalisht e integruar) është e përcaktuar qartë në Statutin e ALBGAS, ku specifikohen detyrat, kompetencat dhe kufizimet që garantojnë ndarjen dhe pavarësinë funksionale.

- ALBGAS ka të drejta vendimmarrëse të pavarura, që nuk mund të kufizohen nga shoqëria mëmë në lidhje me menaxhimin, zhvillimin e rrjetit, planifikimin teknik apo operacional.
- Personat përgjegjës për menaxhimin e ALBGAS nuk marrin pjesë në strukturat drejtuese të shoqërisë mëmë që kanë lidhje me aktivitetet tregtare apo operacionale të tjera (furnizim, tregtim, etj.), në mënyrë që të ruhet pavarësia dhe integriteti i funksionimit të operatorit të gazit.
- Administratorët e shoqërisë mëmë nuk mund të japin udhëzime operacionale që lidhen me aktivitetet e përditshme të ALBGAS, si p.sh. vendime mbi ndërtimin, mirëmbajtjen apo rikonstruksionin e segmenteve të rrjetit të gazit.

Ky parim i ndarjes së qartë garanton një administrim të pavarur, të paanshëm dhe transparent të sistemit të gazit.

Mbikëqyrja ekonomike dhe menaxheriale

Shoqëria mëmë ka të drejtën për të ushtruar mbikëqyrje ekonomike dhe menaxheriale mbi ALBGAS vetëm në kuadrin e përcaktuar nga statuti dhe ligji, përmes:

- miratimit të planeve ekonomike e financiare;
- mbikëqyrjes së krijimit të kapitalit dhe kufizimit të borxhit;
- kontrollit të përgjithshëm strategjik (jo operacional).

Ky mekanizëm është në përputhje me rregullat ligjore për mbikëqyrjen korporative, duke ruajtur balancën ndërmjet autonomisë operacionale dhe përgjegjësisë ekonomike.

Objektivat e Programit të Përputhshmërisë

Programi i Përputhshmërisë i ALBGAS ka për qëllim:

- Parandalimin e çdo sjelljeje diskriminuese ndaj palëve të treta;
- Zbatimin e detyrimeve ligjore dhe rregullatore për ndarjen funksionale dhe ligjore;
- Monitorimin e vazhdueshëm të përputhshmërisë në çdo aktivitet të shoqërisë;
- Rritjen e transparencës dhe sigurisë ligjore në operacione;
- Përcaktimin e detyrimeve individuale të punonjësve për zbatimin korrekt të programit.

7.1 Ndarja ligjore

Në përputhje me nenin 11 dhe nenin 46 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, ALBGAS Sh.a. është e pavarur ligjërisht nga çdo subjekt tjetër që zhvillon aktivitete konkurruese në sektorin e energjisë. Shoqëria është një person juridik më vete, me statut të miratuar dhe me të gjitha strukturat e nevojshme administrative dhe vendimmarrëse të përcaktuara qartë.

Kjo pavarësi ligjore siguron që asnjë palë e tretë të mos ketë kontroll ose ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen operacionale të shoqërisë, përveç kompetencave që i takojnë ligjërisht

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

aksionerit të vetëm – Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë – në rolin e Asamblesë së Përgjithshme.

Zbatimi i këtij programi siguron që shoqëria:

- të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar, për të siguruar funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes.
- të hartojë dhe të depozitojë në organet kompetente një program vjetor të detajuar.

7.2 Ndarja funksionale

Për të garantuar neutralitetin operacional dhe për të parandaluar çdo konflikt interesi, ALBGZ ka vendosur rregulla të brendshme që sigurojnë ndarjen e funksioneve të saj në:

- Strukturat për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit natyror, që veprojnë në mënyrë të pavarur nga çdo aktivitet tregtar;
- Strukturat mbështetëse administrative dhe financiare;
- Njësitë e specializuara për marrëdhëniet me rregullatorin, raportimin dhe përputhshmërinë.

Asnjë person i punësuar në ALBGZ nuk mund të ushtrojë funksione në njëkohësi në subjekte që merren me tregtimin, furnizimin apo aktivitetet konkurruese në sektorin e energjisë, në përputhje me kërkesat e nenit 46 të ligjit.

Procesi i ndarjes funksionale lidhet me ndarjen e aseteve dhe detyrimeve nga shoqëria mëmë dhe sigurimin e përdorimit të tyre në mënyrë efektive, në shërbim të realizimit të objektivave të ALBGZ sh.a. Ky ka qenë një proces kompleks dhe afatgjatë, i cili ka kërkuar një sërë vendimesh organizative dhe një periudhë të konsiderueshme implementimi.

Në mënyrë të veçantë, ndarja e të drejtave dhe detyrimeve të shoqërisë sipas pasqyrës së bilancit u shoqërua me analiza të hollësishme të të dhënave të regjistruara dhe me përdorimin e një metodologjie të veçantë ndarjeje. Kjo kërkoj një kohë të zgjeruar pune dhe u shtri pothuajse gjatë gjithë vitit 2020, duke përfshirë verifikime të shumëfishta financiare, teknike dhe juridike.

Gjithashtu, ky proces kërkoj rishikimin dhe përshtatjen e skemës organizative të shoqërisë, me qëllim rritjen e efikasitetit në menaxhim dhe administrim, si dhe për të theksuar se ALBGZ sh.a. ndodhet në një proces të vazhdueshëm transformimi strukturor dhe funksional. Përmirësime të mëtejshme në këtë drejtim janë parashikuar të jenë objekt i vendimmarrjeve strategjike në vijim.

Ndarja dhe pavarësia

Me Vendim nr. 179, datë 08.11.2017, shoqëria “Albgaz” sh.a. është certifikuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror, në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68 dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe me nenin 9, pika 6 të Direktivës 73/2009/EC. Certifikimi i lartpërmendur është aktualisht i kushtëzuar, si për transmetimin ashtu edhe për shpërndarjen e gazit natyror. Për plotësimin e një sërë kushtesh, ERE herë pas here ka vendosur dhe rivendosur afate përmes vendimeve të mëposhtme:

1. Vendimi nr. 188, datë 10.11.2017

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

2. Vendimi nr. 63, datë 23.04.2019
3. Vendimi nr. 221, datë 20.12.2019
4. Vendimi nr. 37, datë 04.03.2019
5. Vendimi nr. 220, datë 20.12.2019
6. Vendimi nr. 261, datë 19.12.2018
7. Vendimi nr. 36, datë 04.03.2019
8. Vendimi nr. 59, datë 02.04.2024

Së fundmi, me Vendimin nr. 272, datë 10.12.2024, është vendosur të shtyhet sërish afati i depozitimit të dokumentacionit të munguar deri më datë 31.12.2025. Për shtyrjen e këtij afati, ERE është mbështetur në nenin 53, pika 2, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohet: “Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.” Shoqëria ka bërë me dije se vijon punën për zhvillimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, një proces ku Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka rol kyç si institucioni përgjegjës për politikat dhe mbikëqyrjen e projekteve të zhvillimit.

1. Ndarja

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë. 16.08.2021 “për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAS sh.a” i ndryshuar, dhe shkresës së ALBGAS nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “vënie në dispozicion të informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025”

- **ALBGAS i plotëson kërkesat e programit** pasi zhvillon aktivitetin e saj të ndarë nga aktivitetet e tjera që nuk kanë lidhje me transmetimin e gazit natyror në përputhje me Nenin 36 të Ligjit Nr. 102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror. Albgaz sh.a., në përmbushje të konstatimeve që i referohen pikës 5 dhe 6, të Kreut II, të Programit të Përputhshmërisë (Statusi ligjor dhe struktura e korporatës së OST) dhe të pikës 15, të Kreut III, që ka të bëjë me ndarjen e pronësisë dhe pavarësinë e OST, Albgaz Sh.a. i ka bërë me dije Entit Rregullator të Energjisë se ka marrë të gjitha masat dhe aktualisht jemi në proces konsultimi të gjerë me të gjithë aktorët që janë të përfshirë apo me ndikim në vendimmarrje.
- Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë. 16.08.2021 “për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAS sh.a” i ndryshuar, dhe shkresës së ALBGAS nr. 44/3 Prot datë, 14.10.2026 “vënie në dispozicion të informacionit të kërkuar nëpërmjet shkresës nr. 44/2 prot datë, 13.10.2026” ka siguruar dhe garantuar ndarjen e duhur të ALBGAS, duke marrë masa që i njëjti person ose të njëjtët persona të emëruar, anëtarë të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ALBGAS të mos kenë të drejtë që njëkohësisht të ushtrojnë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi vendimmarrjen e

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

subjektit që kryen veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të gazit natyror, si dhe të jenë anëtarët të këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të e të gazit natyror dhe veprimtarinë e ALBGAS ose rrjetit të transmetimit.

2. Pavarësia drejtuese

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë. 16.08.2021 “për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAS sh.a” i ndryshuar, dhe shkresës ALBGAS nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “vënie në dispozicion të informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025” duke marrë masa që për të arritur pavarësinë e drejtuesve. Për sa i përket pavarësisë së drejtuesve të ALBGAS, të tillë si Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës, Administratori, kryetarët dhe personeli udhëheqës (drejtuesit e njësisë strukturore), janë të pavarur nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë e saj. Për këtë qëllim, janë zbatuar kërkesat e mëposhtme:

- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk janë të lidhur profesionalisht me kompani vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.
- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk kanë interes apo marrin përfitime financiare në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre.
- Pagat e drejtuesve në Albgaz sh.a. vendosen në bazë të elementëve të paracaktuar që kanë lidhje me performancën e Albgaz sh.a., siç specifikohet tek kontrata e punësimit dhe/ose tek udhëzimet e punësimit.
- Transferimi i drejtuesve të Albgaz sh.a. tek kompanitë vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe anasjelltas, është parashikuar të bëhet sipas kushteve transparente të vendosura qartë tek Statuti i Albgaz sh.a. dhe do ndiqet rregullisht, dhe asnjë nga këto transferime nuk do mund të paracaktohen që në fillim.
- Drejtuesit e Albgaz sh.a. nuk kanë aksione të kompanive vertikalisht të integruara ose ndonjë pjesë të tyre, dhe nuk kanë konflikte të mundshme interesi që kanë lidhje me këto aksione.

3. Pavarësia funksionale dhe Vendimarrëse

Aktualisht, në lidhje me parashikimet afatgjata të rrjetit, të cilat janë përfshirë në Planin 10-vjeçar të Investimeve, ju bëjmë me dije se ky plan është në proces shqyrtimi nga ERE, me qëllim harmonizimin e tij në përputhje me dinamikat afatshkurtra të sektorit të gazit në Shqipëri.

Pasi të përfundojë i gjithë procesi, dokumenti përfundimtar do t’u vihet në dispozicion si juve, ashtu edhe aktorëve të tjerë të interesuar të sektorit, nëpërmjet faqes sonë zyrtare të internetit: www.albgaz.al.

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe të pikës 66 të Programit të Përputhshmërisë dhe kontratës së lidhur ndërmjet ALBGAS dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, shoqëria ALBGAS ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit korrekt të Programit të Përputhshmërisë.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

Ky program ka funksionuar në bazë dhe sipas kompetencave të përcaktuara me ligj, duke mbledhur të gjithë informacionin e nevojshëm nga çdo drejtori dhe punonjës që mbulon një sektor të caktuar. Zyrtari i Përputhshmërisë ka pasur gjithashtu akses të plotë në zyrat e shoqërisë ALBGAS, si dhe tek i gjithë informacioni i nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij ligjore.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimet e Bordit të ERE vendimin Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë. 16.08.2021 “për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAS sh.a” i ndryshuar, dhe shkresës së ALBGAS nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025”. ALBGAS ka pavarësi totale funksionale dhe Vendimarrëse. ALBGAS mbështetur në Ligjin nr.102/2015 Për Sektorin e Gazit Natyror, si dhe akteve të tjera ligjore dhe Kodit të Rrjetit të Transmetimit është përgjegjës për dhënien aksesit për palët e treta, përfshirë mbledhjen e detyrimeve të aksesit dhe detyrimeve të kongestionit, për funksionimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit si dhe për të siguruar një mundësi afatgjatë të sistemit të transmetimit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme përmes planifikimit të investimeve. Me zhvillimin e sistemit të transmetimit, ALBGAS është përgjegjëse për planifikimin (duke përfshirë procedurën e autorizimit), ndërtimin dhe autorizimin e infrastrukturës së re të gazit. ALBGAS është e pavarur në planifikimin e investimeve në lidhje me sistemin e transmetimit sipas kërkesave të Ligjit 102/2015 dhe akteve të tjera ligjore në zbatim, dhe duhet të përputhet me planin e miratuar dhjetë-vjeçar për zhvillimin e rrjetit të transmetimit dhe të monitorohet nga Enti Rregullator i Energjisë. ALBGAS mban në dispozicion burimet e kërkuara financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të kryer detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror.

8. PËRJASHTIMI I SJELLJES DISKRIMINUESE

Kushtet dhe procedurat përcaktohen në lidhje me ofrimin e Shërbimeve të Transmetimit të Gazit Natyror, me qëllim parandalimin e çdo trajtimi diskriminues nga ana e ALBGAS sh.a. dhe sigurimin e një qasjeje të barabartë për të gjithë përdoruesit e rrjetit.

Lidhja në sistemin e transmetimit është një proces që mundëson lidhjen e përdoruesve të gazit me rrjetin kombëtar në mënyrë të sigurt, efikase dhe transparente. Ky proces përfshin instalimin e infrastrukturës dhe pajisjeve të nevojshme, si dhe miratimin përkatës nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), për të siguruar që tarifat dhe shërbimet të jenë të drejta dhe të justifikueshme për çdo përdorues.

Në përputhje me Ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, një nga parimet themelore të Programit të Pajtushmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (ALBGAS) është siguri i barazisë dhe shmangia e çdo forme diskriminimi në ofrimin e shërbimeve dhe ndërveprimet me përdoruesit e rrjetit, klientët, tregtarët, furnizuesit dhe palët e tjera të interesuara. Programi synon të garantojë që të gjitha vendimet dhe veprimet e ndërmarra nga ALBGAS të jenë të drejta, transparente dhe të paanshme, pa ndikuar nga interesa të jashtme politike, tregtare apo të tjera të papërshtatshme.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

Për të eliminuar sjelljet diskriminuese ndaj përdoruesve të rrjetit të transmetimit të gazit, ALBGAZ zbaton një sërë rregullash dhe mekanizmash si më poshtë:

- Mbrojtja nga diskriminimi në ofrimin e shërbimeve

ALBGAZ siguron që të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, duke garantuar që asnjë përdorues të mos ketë avantazhe apo disavantazhe të padrejta.

- Tarifa të drejta dhe të barabarta

Përcaktimi i tarifave dhe pagesave bëhet në mënyrë transparente, të drejtë dhe të barabartë për të gjithë përdoruesit, duke u bazuar në kostot reale të shërbimeve të ofruara dhe në metodologjinë e miratuar nga ERE.

- Transparenca

ALBGAZ garanton transparencë të plotë në proceset e përcaktimit të tarifave, kushteve të aksesit dhe politikave të tjera, duke publikuar informacion të qartë mbi metodat, kriteret dhe procedurat e përdorura.

- Konsultimi me përdoruesit e rrjetit

Shoqëria zhvillon konsultime të rregullta me përdoruesit ekzistues dhe potencialë të rrjetit për të adresuar shqetësimet, nevojat dhe për të marrë mendime lidhur me politikat dhe procedurat operative.

- Mekanizmat e ankesave dhe korrigjimeve

Janë përcaktuar mekanizma të qartë dhe efikas për trajtimin e ankesave të përdoruesve në rast se konstatojnë trajtim të pabarabartë apo shkelje të parimeve të aksesit jo-diskriminues.

- Ndërtimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me përdoruesit

ALBGAZ synon forcimin e marrëdhënieve me përdoruesit e rrjetit, për të kuptuar më mirë nevojat e tyre dhe për të ofruar shërbime që përputhen me kërkesat e tregut dhe standardet rregullatore.

- Monitorimi i përdorimit të rrjetit

Shoqëria kryen monitorim të vazhdueshëm të përdorimit të rrjetit për të identifikuar shenja të mundshme të diskriminimit dhe për të ndërhyrë në kohë për korrigjimin e çdo sjelljeje të padrejtë.

Përmes këtyre masave, ALBGAZ garanton që rrjeti i transmetimit të gazit natyror ofrohet në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe transparente për të gjithë përdoruesit, duke respektuar standardet kombëtare dhe evropiane për qasje jo-diskriminuese dhe përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi.

Aksesi në sistemin e transmetimit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimet e Bordit të ERE vendimin nr. nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “vënie në Zyrtari i Përputhshmërisë , ALBGAZ SH.A.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

dispozicion të informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025”: ALBGAS i plotëson kërkesat e Programit duke marrë masa të sigurojë akses të barabartë dhe jo diskriminues. Në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” shoqëria Albgaz sh.a ka hartuar dhe dërguar për miratim “Programin e Përputhshmërisë” i cili është filtri/garancia e fundit për garantimin e zbatimit me përpikmëri të dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Albgaz sh.a. ka marrë të gjitha masat për të siguruar akses të barabartë dhe jo diskriminues në sistemin e transmetimit.

- Për sa i përket tarifës së transmetimit, Bordi i ERE me vendim nr. 313, datë 12.12.2025 vendosi ; LËNIEN NË FUQI PËR VITIN 2026 TË TARIFËS SË PËRKOHSHE TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR NGA SHOQËRIA “ALBGAS” SH.A. MIRATUAR VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 206, DATË 16.12.2019.

9. KONKURRENCA DHE MARREDHENIET KOMERCIALE

ALBGAS sh.a. angazhohet të respektojë dhe të sigurojë zhvillimin e një tregu të gazit natyror të drejtë dhe konkurrues, në përputhje me parimet dhe kërkesat e legjislacionit dhe rregulloreve përkatëse. Aktivitetet e ALBGAS sh.a. nuk duhet të kufizojnë, pengojnë apo të ndikojnë negativisht në konkurrencën e ndërshe në tregun e gazit, duke garantuar një qasje të barabartë dhe jo-diskriminuese për të gjithë aktorët e tregut, përfshirë përdoruesit e rrjetit, operatorët, furnizuesit dhe tregtarët.

Për të përmbushur këto kërkesa, ALBGAS sh.a. ka ndërmarrë një sërë masash:

- Kërkesat teknike për lidhje në rrjet

Kërkesat teknike për lidhjen në sistemin e transmetimit janë të njëjta për të gjithë përdoruesit dhe përmbushin standardet e sigurisë dhe efikasitetit, pa diskriminim ndaj asnjë pale.

- Procedurat dhe afatet për lidhje

Procedurat për lidhje janë të standardizuara, të qarta dhe të publikuara për të gjithë përdoruesit potencialë. Afatet kohore janë të përcaktuara dhe respektohen në mënyrë të barabartë, duke garantuar transparencë dhe efikasitet në procesin e lidhjes.

- Standardizimi i kushteve kontraktuale dhe komerciale

ALBGAS ka implementuar kushte kontraktuale dhe komerciale të njëjta për të gjithë përdoruesit e rrjetit, në përputhje me praktikën më të mirë të tregut dhe me të drejtat e përdoruesve, pa krijuar avantazhe të padrejta për ndonjë palë.

- Struktura e qartë e tarifave të lidhjes

Tarifat e lidhjes janë të përcaktuara në mënyrë transparente dhe të arsyeshme, duke reflektuar kostot reale të ofrimit të shërbimeve dhe duke shmangur çdo barrierë të padrejtë për hyrjen në rrjet.

- Cilësia e shërbimeve dhe mirëmbajtja

ALBGAS angazhohet të ofrojë një cilësi të lartë shërbimi për mirëmbajtjen dhe rregullimin e problemeve në rrjetin e transmetimit, në mënyrë të barabartë dhe të shpejtë për të gjithë përdoruesit, pa dallime të paarsyeshme.

- Marrëdhëniet me shoqëri të lidhura dhe partnerë

ALBGAS mund të ketë marrëdhënie tregtare edhe me shoqëri të tjera të lidhura apo me operatorë të tjerë të tregut të gazit, përfshirë bashkëpunime për menaxhimin e infrastrukturës, shkëmbimin e

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

të dhënave dhe koordinimin teknik, duke respektuar gjithmonë parimin e ndarjes funksionale dhe të konfliktit të interesit.

- Marrëdhëniet me përdoruesit e rrjetit

ALBGAZ zhvillon marrëdhënie kontraktuale me përdoruesit e rrjetit për ofrimin e shërbimeve të transmetimit, lidhjeve të reja, mirëmbajtjes dhe shërbimeve të tjera, sipas tarifave dhe kushteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).

- Marrëdhëniet me operatorët e tregut të gazit

ALBGAZ bashkëpunon me operatorë të tregut dhe furnizues, përfshirë shkëmbimin e informacionit mbi planifikimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e flukseve, në përputhje me rregullat për konkurrencë të ndershme dhe qasje të barabartë.

Rregullat për parandalimin e kufizimeve të konkurrencës dhe qasje jo-diskriminuese

Për të garantuar konkurrencë të ndershme dhe qasje të barabartë në rrjet, ALBGAZ zbaton rregulla dhe mekanizma të qartë, duke përfshirë:

- Transparencën e informacionit

ALBGAZ siguron që informacioni në lidhje me proceset teknike, kërkesat për lidhje dhe shërbimet e rrjetit të jetë publik, i qartë dhe i aksesueshëm për të gjithë operatorët dhe përdoruesit. Kjo përfshin publikimin e dokumenteve, raportimin e performancës, konsultimet me palët e interesuara dhe auditimet e pavarura.

- Procedurat e hapura për qasje në rrjet

ALBGAZ ka procedura të përcaktuara dhe të njëjta për të gjithë përdoruesit që kërkojnë qasje në rrjet, pa favorizuar asnjë operator. Kjo përfshin aplikimin e kriterëve teknike dhe tregtare në mënyrë të barabartë dhe monitorimin e pavarur të procesit.

- Rregullimi i çmimeve dhe tarifave

Tarifat dhe çmimet aplikohen në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit, sipas metodologjive të miratuara nga ERE. Monitorimi periodik siguron që ato të jenë të drejta, transparente dhe të paanshme.

- Monitorimi dhe raportimi i ndarjes funksionale

Aktivitetet e ALBGAZ monitorohen nga ERE për të garantuar respektimin e rregullave të konkurrencës dhe ndarjen e funksioneve nga aktivitetet e tjera tregtare. Kjo përfshin raportime financiare, auditime të rregullta dhe transparencë në proceset vendimmarrëse.

- Ndarja e funksioneve

Për të parandaluar konfliktet e interesit dhe për të garantuar konkurrencë të drejtë në treg, ALBGAZ zbaton ndarjen e qartë të përgjegjësiave ndërmjet funksioneve të transmetimit dhe çdo aktiviteti tjetër, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë. 16.08.2021 “për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAZ sh.a” i ndryshuar, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “vënje në dispozicion të informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025”: ALBGAZ i plotëson kërkesat e programit. Për sa i takon konkurrencës dhe

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

marredhenieve komerciale, përgjate vitit 2025 nuk është raportuar asnjë shkelje apo keqmenaxhim i veprimtarisë tregtare si në përgjithësi ashtu edhe lidhur me raste të vecanta. Mungesa e aktivitetit të transmetimit përgjatë vitit 2025 ka bërë që shoqëria ALBGAZ të mos nuk kufizojë apo ndikojë në asnjë mënyrë në konkurrencën e drejtë në tregun e gazit natyror në vënd.

- Përgjatë vitit 2025 shoqëria ALBGAZ nuk ka nënshkruar dhe për rrjedhojë nuk ka njoftuar ERE për kontratë transmetimi.

10.ZBATIMI I PARIMEVEVE

ALBGAZ sh.a., në cilësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes të Gazit Natyror në Republikën e Shqipërisë, ka implementuar dhe vazhdon të zbatojë një qasje të fortë dhe të strukturuar për të siguruar objektivitetin, transparencën dhe paanësinë në të gjitha aktivitetet e saj.

Ky angazhim është thelbësor për të ofruar shërbime të drejta, të besueshme dhe jo-diskriminuese për përdoruesit e rrjetit të transmetimit dhe për të ruajtur besimin publik, integritetin institucional dhe konkurrencën e ndershme në tregun e gazit natyror.

Objektiviteti

Objektiviteti përbën një nga shtyllat kryesore të funksionimit të ALBGAZ sh.a. Të gjitha vendimet, veprimet dhe procedurat ndërmerren në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet teknike, pa favorizuar asnjë palë të caktuar.

Zbatimi i objektivitetit përfshin:

- Vlerësimin pa ndikime të jashtme

Kërkesat për lidhje në rrjet dhe për ofrimin e shërbimeve të transmetimit vlerësohen në mënyrë të paanshme, pa ndikuar nga faktorë tregtarë, politikë apo të lidhjeve të tjera jo-relevante.

- Kushte të barabarta për të gjitha palët

Të gjitha procedurat teknike, komerciale dhe kontraktuale janë të standardizuara dhe të aplikueshme në mënyrë të njëjtë për të gjithë përdoruesit, pa përjashtime.

- Vendime të bazuara në kritere objektive

Vendimet që lidhen me lidhjet në rrjet, alokimin e kapaciteteve, tarifatat dhe shërbimet bazohen në kritere të qarta, të arsyeshme dhe të dokumentuara, të miratuara nga ERE dhe të publikuara për palët e interesuara.

Transparenca

Transparenca është një komponent thelbësor për të ndërtuar dhe ruajtur besimin e përdoruesve të rrjetit dhe të tregut në tërësi. ALBGAZ siguron që të gjitha informacionet e rëndësishme të jenë të qarta, të sakta dhe lehtësisht të aksesueshme për publikun dhe palët e interesuara.

Zbatimi i transparencës përfshin:

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

- Publikimin e procedurave dhe politikave
ALBGAZ publikon në mënyrë të rregullt të gjitha procedurat e lidhjes në rrjet, tarifat e aplikueshme, kushtet standarde kontraktuale dhe çdo ndryshim që ndikon në përdoruesit.
- Raportimin e performancës dhe aktiviteteve
Shoqëria është e detyruar të raportojë periodikisht në ERE mbi performancën operacionale, kapacitetet e disponueshme, cilësinë e shërbimeve dhe investimet e planifikuara. Këto raporte janë gjithashtu të aksesueshme për palët e interesuara.
- Mbikëqyrjen dhe auditimin e jashtëm
ALBGAZ i nënshtrohet mbikëqyrjes nga ERE dhe auditimeve të pavarura të aktiviteteve, për të siguruar që çdo veprim është në përputhje me ligjin dhe me standardet e transparencës dhe drejtësisë.

Paanshmeria

Paanshmëria nënkupton garantimin që ALBGAZ nuk favorizon asnjë palë, operator apo grup interesi gjatë ushtrimit të funksioneve të saj.

Zbatimi i paanshmërisë përfshin:

- Veprim pa preferenca tregtare apo institucionale

Vendimet për lidhje në rrjet, alokime kapacitetesh dhe shërbime të tjera merren në mënyrë të pavarur, të ndara nga çdo ndikim tregtar apo politik.

- Trajtim i barabartë i të gjithë përdoruesve të rrjetit

ALBGAZ siguron shërbime të njëjta për të gjithë përdoruesit në rastet e mirëmbajtjes, ndërprerjeve apo kërkesave për mbështetje teknike, duke respektuar vetëm kriteret teknike dhe urgjencat objektive.

- Përdorimi i kriterëve të paanshme në ofrimin e shërbimeve

Ndihma për zhvillimin e infrastrukturës apo për lidhjet në rrjet ofrohet në mënyrë të paanshme dhe në përputhje të plotë me rregullat ligjore dhe rregullat e miratuara nga ERE.

Roli i Autoritetit Rregullator të Energjisë (ERE)

Për të garantuar zbatimin e plotë të këtyre parimeve, ALBGAZ është nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e ERE, e cila:

- Miraton tarifat dhe procedurat standarde;
- Mbikëqyr zbatimin e ligjit dhe rregulloreve;
- Kryen auditime dhe verifikime periodike për të siguruar përputhshmërinë dhe integritetin operacional.

Mekanizmat e Monitorimit dhe Auditimit

ALBGAZ është e detyruar të garantojë monitorim të jashtëm dhe auditim të rregullt, për të siguruar që praktikat e saj janë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane.

Kjo përfshin:

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

- Auditime të jashtme të proceseve të lidhjes dhe shërbimeve të rrjetit;
- Kontrollin e përdorimit të fondeve dhe çmimeve të aplikuara;
- Zbatimin në kohë të rekomandimeve të dhëna nga autoritetet rregullatore.

Zbatimi i këtyre parimeve është thelbësor për krijimin dhe ruajtjen e një tregu të gazit natyror konkurrues, të hapur dhe të drejtë. ALBGAZ ka përgjegjësinë ligjore dhe institucionale për të siguruar trajtim të barabartë dhe jo-diskriminues për të gjithë aktorët e tregut, ndërsa ERE dhe mekanizmat e auditimit të pavarur garantojnë zbatimin e tyre në praktikë.

Konflikti i interesit

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit të Bordit të ERE vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “vënie në dispozicion të informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025”: ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit nuk ka asnjë shkelje. Në lidhje me konfliktet e interesit, përgjatë vitit 2025, nuk është sinjalizuar asnjë shkelje apo abuzim i punonjësve të shoqërisë ALBGAZ nga ana e Bilbilfryresit apo e ndonjë individi tjetër të brendshëm apo të jashtëm të shoqërisë.

11. E DREJTA E INFORMIMIT

ALBGAZ ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar informacionin, konfidencialitetin dhe transparencën ndaj publikut duke i ofruar akses të barabartë përdoruesve në të gjitha dokumentacionet që disponon pasi është e detyruar të publikojë në faqen zyrtare të korporatës, sipas kuadrit rregullator që rregullon veprimtarinë e saj.

ALBGAZ sh.a., në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet strukturave të saj të brendshme dhe nën mbikëqyrjen e autoriteteve rregullatore, ka realizuar një punë të rëndësishme për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm, si dhe për të garantuar respektimin e plotë të kërkesave ligjore dhe rregullatore që lidhen me mbrojtjen e të dhënave dhe të drejtën për informim.

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është plotësisht në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në fuqi, përfshirë:

- Ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”
- Kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit të klasifikuar
- Udhëzimet e ERE për programet e pajtueshmërisë

ALBGAZ ka zbatuar mekanizma të qartë, politika të miratuara dhe rregulla të brendshme të forta për mbrojtjen e informacionit komercial dhe operacional, duke siguruar që:

- Informacioni i ndjeshëm të mbrohet nga qasjet e paautorizuara
- Shoqëritë e lidhura nuk gëzojnë avantazhe diskriminuese në aksesin në këtë informacion
- Të gjitha procedurat dhe politikat e sigurisë të jenë të dokumentuara, të audituara dhe të përditësuara rregullisht

Mbrojtja e informacionit të ndjeshëm

Zyrtari i Përputhshmërisë , ALBGAZ SH.A.

Faqe 28

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

Pikat kryesore të sistemit të mbrojtjes së informacionit përfshijnë:

- Mekanizmat e brendshëm të sigurisë
ALBGAS ka përcaktuar mekanizma të brendshëm për klasifikimin, ruajtjen dhe ndarjen e informacionit të ndjeshëm, në mënyrë që të garantohet ndarja funksionale dhe parandalimi i çdo përdorimi të padrejtë të të dhënave nga shoqëritë e lidhura apo operatorë të tretë.
- Politikat e mbrojtjes së të dhënave
Politikat përfshijnë masat teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave tregtare dhe operacionale, si dhe procedurat për qasje të autorizuar, enkriptim, regjistrim të aksesit dhe mbikëqyrje të vazhdueshme.
- Përputhshmëri me standardet e sigurisë kibernetike
Departamenti TIK ka zbatuar plane të vazhdueshme për përmirësimin e sigurisë, përfshirë business continuity & disaster recovery, cyber recovery, segmentim të avancuar të rrjetit kompjuterik, autentifikim të centralizuar, filtrime DNS dhe URL, si dhe mbrojtje ndaj sulmeve të tipit DDoS.

11.1 E drejta për informim dhe transparencë

Qëllimi kryesor i së drejtës për informim është të sigurojë transparencë të plotë për përdoruesit e rrjetit dhe palët e tjera të interesuara, në lidhje me shërbimet, politikat dhe ndryshimet që ndikojnë në cilësinë dhe kushtet e aksesit në rrjetin e gazit.

ALBGAS angazhohet të sigurojë që çdo përdorues të ketë akses të lehtë, të kuptueshëm dhe të barabartë në informacionin e nevojshëm përmes:

- Faqes zyrtare të internetit (www.albgaz.al)
Publikohen raportet vjetore, tarifat, procedurat për lidhje, politikat e shërbimeve dhe të dhëna mbi performancën e rrjetit të transmetimit.
- Raportet vjetore të performancës
Përfshijnë informacion mbi sigurinë, kapacitetet, investimet dhe zhvillimet kryesore.
- Publikimeve të vazhdueshme
Politikat, tarifat, procedurat e ankesave dhe çdo dokument tjetër i rëndësishëm publikohen rregullisht dhe janë lehtësisht të aksesueshme.
- Konsultimeve publike
ALBGAS organizon konsultime dhe sesione informuese për politikat e reja, metodologjitë tarifore dhe ndryshimet me ndikim në përdoruesit.
- Njoftimeve dhe komunikimit të drejtpërdrejtë
Përmes e-mail-eve, buletineve informative dhe platformave online, përdoruesit informohen në kohë reale për çdo zhvillim të rëndësishëm.
- Qendrës së shërbimeve për përdoruesit
Ofron asistencë të drejtpërdrejtë për përdoruesit dhe operatorët në lidhje me procedurat, ankesat dhe kërkesat për informacion.

11.2 Rëndësia e mbrojtjes së informacionit dhe transparencës

Mbrojtja e informacionit të ndjeshëm dhe respektimi i së drejtës për informim janë thelbësore për ndërtimin e një mjedisi të besueshëm tregtar dhe rregullator, për parandalimin e diskriminimit dhe për ruajtjen e konkurrencës së ndershme në tregun e gazit natyror.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

Përmes zbatimit rigoroz të këtyre politikave, ALBGAZ siguron një komunikim të hapur, të drejtë dhe të qartë me të gjithë aktorët e tregut dhe autoritetet mbikëqyrëse.

Sigurimi i informacionit

Shoqëria ALBGAZ ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar informacionin, konfidencialitetin dhe transparencën ndaj publikut, duke u ofruar akses të barabartë të gjithë përdoruesve në dokumentacionin që disponon. Kjo, në përputhje me detyrimin për të publikuar informacion në faqen zyrtare të shoqërisë, sipas kuadrit rregullator që rregullon veprimtarinë e saj.

Në zbatim të kushteve dhe kërkesave të Programit të Përputhshmërisë, të miratuar me Vendimin nr. 345, datë 21.12.2022, të Bordit të ERE, si dhe në përputhje me shkresën e ALBGAZ nr. 122/1 Prot., datë 17.10.2023, shoqëria zbaton kërkesat e përcaktuara në program.

Shoqëria ALBGAZ disponon faqen zyrtare të internetit: www.albgaz.al. Gjithashtu, çdo kontratë transmetimi, Kodi i Rrjetit, tarifat e transmetimit, etj., janë të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe të publikuara në faqen e saj zyrtare: www.ere.gov.al

Çdo operator i interesuar mund të kryejë kërkesën e tij për përdorimin e rrjetit të transmetimit të gazit natyror nëpërmjet këtyre kanaleve zyrtare.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë. 16.08.2021 “për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAZ sh.a” i ndryshuar, dhe shkresës së ALBGAZ nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “vënie në dispozicion të informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025”:ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.

Konfidencialiteti i informacionit

Ashtu si në fillimet e shoqërisë ALBGAZ, konfidencialiteti i informacionit ka qenë një nga objektivat kryesorë të vëmendjes. Në kontratën e punësimit, konkretisht në nenin 16 të saj, parashikohet: “Konfidencialiteti dhe konflikti i interesit”, ku përcaktohet se çdo punonjës i shoqërisë ALBGAZ ka detyrim kontraktual të ruajë konfidencialitetin e informacionit, përveç zbatimit të Programit të Përputhshmërisë.

Gjithashtu, neni 18 i Kodit të Etikës të ALBGAZ (shkresa nr. 19 prot., datë 10.02.2026) rregullon marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë dhe punonjësve të saj, si gjatë periudhës kur ata janë të punësuar pranë shoqërisë, ashtu edhe pas përfundimit të marrëdhënieve të punësimit.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit e Bordit të ERE vendimin nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “vënie në dispozicion të

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025”:ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.

Informacioni publik

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

- Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE vendimin Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë. 16.08.2021 “për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAZ sh.a” i ndryshuar, dhe shkresës së ALBGAZ nr. nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “vënie në dispozicion të informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025”:ALBGAZ i plotëson kërkesat e Programit.
- Shoqëria ALBGAZ disponon faqen web www.albgaz.al, gjithashtu çdo kontratë transmetimi, kodi i rrjetit, tarifën e transmetimit etj, janë të miratuar nga ERE dhe të publikuar në faqen e saj web www.ere.gov.al, ku çdo operator i interesuar mund të kryejë kërkesën e saj për përdorimin e rrjetit të transmetimit të gazit natyror.

12.ZBATIMI I PROGRAMIT TE PAJTUESHMERISE

Programi i Përputhshmërisë i miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 345, datë 21.12.2022, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE nr. 171, datë 16.08.2021 ‘Për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAZ sh.a.’”, i ndryshuar, është hartuar në formën e një rregulloreje të brendshme detyruese. Ky program përmban angazhime të detyrueshme për të gjithë drejtuesit, punonjësit dhe përfaqësuesit e autorizuar të ALBGAZ, përfshirë audituesit, këshilltarët, kontraktorët, pjesëmarrësit dhe përdoruesit e rrjetit të transmetimit, si dhe palët e treta që bashkëveprojnë me shoqërinë. Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, pika 66 e programit të përputhshmërisë si dhe kontratës së lidhur midis ALBGAZ dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, shoqëria ALBGAZ ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të mundësuar monitorimin e vazhdueshëm për zbatimin siç duhet të Programit të Përputhshmërisë, i cili ka funksionuar në bazë dhe sipas kompetencave të dhëna nga ligji, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm nga secila drejtori dhe apo punonjës që ka mbuluar një sektor të caktuar. Zyrtari gjithashtu ka pasur aksesin në zyrat e shoqërisë ALBGAZ, tek i gjithë informacioni i nevojshëm që duhet pëtër kryer detyrat e tij.

12.1 Informimi dhe ndërgjegjësimi i stafit

Në kuadër të zbatimit të programit, pas miratimit të organigramës së re, është siguruar që të gjitha drejtoritë dhe strukturat e reja të informohen plotësisht mbi përmbajtjen dhe detyrimet që rrjedhin nga Programi i Përputhshmërisë.

Ky proces ka përfshirë:

- Përhapjen e informacionit të detajuar
- Programi është shpërndarë në mënyrë të strukturuar për çdo drejtor dhe punonjës, në nivelin përkatës, nga Zyrtari i Pajtuësshmërisë. Ky informacion përfshin kërkesat ligjore dhe detyrimet individuale të çdo pozicioni brenda organizatës, si dhe praktikatat më të mira për zbatimin e programit.
- Shpjegimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

Stafi është informuar për ligjet dhe rregulloret që ndikojnë në operacionet e përditshme të ALBGAS, përfshirë normat që lidhen me etikën, konkurrencën, transparencën dhe përgjegjësinë institucionale.

- Përgjegjësitë e drejtuesve të rinj

Çdo drejtues i ri është informuar në mënyrë të qartë për përgjegjësinë e tij në implementimin dhe monitorimin e programit brenda departamentit që drejton, për të siguruar një kuptim të plotë dhe zbatim të saktë të tij.

12.2 Forcimi i zbatimit gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, ALBGAS ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në forcimin e përputhshmërisë me legjislacionin kombëtar dhe standardet më të larta rregullatore, duke fokusuar veprimet në disa drejtime kryesore:

- Përmirësimin e praktikave të monitorimit dhe mbikëqyrjes
Janë zbatuar masa të reja për të forcuar monitorimin e proceseve të brendshme dhe të ndërveprimeve me palët e jashtme, për të siguruar që çdo aktivitet të zhvillohet në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe standardet ndërkombëtare.
- Masat për shmangien e diskriminimit dhe promovimin e barazisë
Është rikonfirmuar angazhimi institucional për të krijuar një mjedis të drejtë dhe të barabartë për të gjithë përdoruesit dhe palët e interesuara, duke parandaluar çdo formë diskriminimi dhe duke promovuar transparencën dhe diversitetin.
- Përditësimin e procedurave të brendshme
Janë rishikuar dhe përditësuar procedurat për t'iu përshtatur ndryshimeve ligjore dhe kërkesave të industrisë, me fokus në rritjen e efikasitetit operacional dhe sigurisë së informacionit.

12.3 Roli i Zyrtarit të Pajtuashmërisë

Zbatimi efektiv i Programit të Përputhshmërisë mbikëqyret nga Zyrtari i Pajtuashmërisë, i cili është plotësisht i pavarur dhe ka akses të plotë në të gjitha informacionet e nevojshme të ALBGAS dhe shoqërive të lidhura, për të përmbushur detyrën e tij.

Pas marrjes së detyrës, Zyrtari i Pajtuashmërisë ka ndërmarrë këto hapa:

- Informimin e plotë të stafit mbi përmbajtjen e programit dhe detyrimet ligjore që rrjedhin prej tij;
- Marrjen e konfirmimeve me shkrim nga të gjithë punonjësit dhe drejtuesit që janë njohur me programin dhe angazhohen ta zbatojnë atë;
- Fillimin e një programi të vazhdueshëm trajnimesh dhe sesione informuese për punonjësit ekzistues dhe të rinj, për të garantuar njohuri adekuate dhe zbatim praktik të detyrimeve të programit;
- Hartimin e Raportit Vjetor të Pajtuashmërisë, që i paraqitet çdo vit Bordit të ERE, ku dokumentohet zbatimi, monitorimi dhe përputhshmëria e proceseve të brendshme të shoqërisë me Programin.

12.4 Mekanizmat e raportimit dhe masat disiplinore

Të gjithë drejtuesit, punonjësit dhe përfaqësuesit e autorizuar të ALBGAS kanë detyrimin të njoftojnë menjëherë Zyrtarin e Pajtuashmërisë në rast shkeljeje të dispozitave të programit.

Në raste konstatimi të shkeljeve, ALBGAS ka të drejtë të aplikojë procedura disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të shoqërisë.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

12.5 Rëndësia strategjike e programit

Zbatimi rigorozi i Programit të Përputhshmërisë është një instrument thelbësor për:

- Parandalimin e çdo praktike diskriminuese;
- Garantimin e shërbimeve të drejta, transparente dhe të besueshme për përdoruesit e rrjetit të transmetimit të gazit;
- Ruajtjen e integritetit institucional dhe përputhshmërinë me kuadrin ligjor kombëtar dhe evropian.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt:

Sipas kushteve dhe kërkesave të pikave të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Sipas kushteve dhe kërkesave të paragrafeve të Programit të Përputhshmërisë të miratuar me Vendimit të Bordit të ERE vendimin Nr. 345, datë 21.12.2022 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 171, datë. 16.08.2021 “për miratimin e Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror ALBGAS sh.a” i ndryshuar, dhe shkresës së ALBGAS nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “**vënie në dispozicion të informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025**”: ALBGAS i plotëson kërkesat e Programit.

- Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.102/2015 “ Për Sektorin e Gazit Natyror”, pikës 66 të Programit të Përputhshmërisë si dhe kontratës së lidhur midis ALBGAS dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, shoqëria ALBGAS ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të mundur monitorimin e vazhdueshëm për zbatim siç duhet të Programit të Përputhshmërisë, i cili ka funksionuar në bazë dhe sipas kompetencave të dhëna nga ligji, duke marrë të gjithë informacionin e nevojshëm nga secila drejtori dhe apo punonjës që ka mbuluar një sektor të caktuar. Zyrtari i Përputhshmërisë gjithashtu ka pasur aksesin në zyrat e shoqërisë ALBGAS, tek i gjithë informacioni i nevojshëm që duhet për të kryer detyrat e tij.

PJESA E DYTË

13.REKOMANDIMET E ZYRTARIT

Objektivat dhe masat për përmirësimin e përputhshmërisë dhe zhvillimin e sektorit të gazit për periudhën 2026.

1. Vlerësimi i rrjetit ekzistues të gazit në Shqipëri dhe dhënia e rekomandimeve teknike dhe rregullatore për integrimin e tij të mundshëm në sistemin kombëtar të ardhshëm të gazit, në përputhje me objektivat kombëtare dhe direktivat evropiane.
2. Shqyrtimi i aplikimeve, analizimi i kostove dhe miratimi i tarifave dhe çmimeve për të licencuarit në sektorin e gazit natyror, përfshirë aktivitetet e transmetimit dhe shpërndarjes, në bashkëpunim me Entin Rregullator të Energjisë (ERE).
3. Zgjerimi i bazës së klientëve fundorë, përmes lidhjeve të reja, shtesave të kapaciteteve ekzistuese dhe rritjes së aksesit në rrjet, në përputhje me objektivat e liberalizimit të tregut dhe diversifikimit të përdoruesve.
4. Prezantimi dhe informimi periodik i stafit mbi Programin e Përputhshmërisë dhe zhvillimet rregullatore, përmes trajnimeve, takimeve dhe komunikimeve të rregullta të brendshme.
5. Njoftimi i Zyrtarit të Përputhshmërisë për mbledhjet e ALBGAS dhe përfshirja aktive e tij në proceset vendimmarrëse që lidhen me zbatimin e programit.
6. Përmirësimi i Programit të Përputhshmërisë, përmes rishikimeve periodike, harmonizimit me ndryshimet ligjore dhe integritet të praktikave më të mira evropiane për sektorin e gazit.
7. Përditësimi i faqes zyrtare të ALBGAS, për të siguruar transparencë dhe akses të barabartë në informacion për të gjithë palët e interesuara (përdorues, operatorë, investitorë, institucione publike).
8. Trajnime të dedikuara mbi Konfidencialitetin e të Dhënave dhe të Drejtën e Informimit, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet e BE-së, për të garantuar ndarjen e qartë të informacionit publik dhe atij të mbrojtur.
9. Implementimi i teknologjive të avancuara për monitorimin dhe menaxhimin në kohë reale të rrjetit të gazit, përfshirë SCADA, sistemet e matjes inteligjente dhe platformat e analizës operative.
10. Hartimi dhe miratimi i Kodit të Rrjetit të Shpërndarjes së Gazit, në bashkëpunim me ERE dhe palët e interesuara, për të siguruar një kuadër të qartë teknik, ligjor dhe operacional për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

Pasi përfundoi investigimi u vërejt dhe sipas përgjigjes së ALBGAS me shkresë nr. 87/1 Prot datë, 4.02.2026 “vënie në dispozicion të informacionit të kërkuar mbi raportin e përputhshmërisë për vitin 2025”:

1. ALBGAS ka strukturuar marrëdhënie institucionale me palë të tjera mbi bazën e protokolleve zyrtare, të cilat garantojnë integritetin dhe transparencën e proceseve. Në kuadër të programeve të bashkëpunimit, këto marrëdhënie monitorohen në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar mbrojtjen e plotë të informacionit tregtar konfidencial, duke shmangur njëkohësisht çdo formë diskriminimi ndaj përdoruesve të rrjetit.
2. Shoqëria ka integruar menaxhimin e rrezeve si pjesë përbërëse të strategjisë së saj organizative. Zyrtari i përputhshmërisë monitoron në mënyrë të veçantë dhe specifike

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

- reziqet që lidhen me pavarësinë vendimmarrëse të OST-së, duke siguruar që asnjë faktor i jashtëm të mos ndikojë në operimin e pavarur dhe të paanshëm të sistemit.
3. ALBGASZ konfirmon se shpenzimet realizohen në përputhje me buxhetin e miratuar nga organet drejtuese. Në përputhje me kërkesat e programit, shoqëria siguron që OST-ja të disponojë aftësi financiare dhe burime të mjaftueshme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjetit, pavarësisht nga aktivitetet e tjera të mundshme të shoqërisë.
 4. Shoqëria garanton zbatimin e plotë të Ligjit nr. 102/2015 dhe të akteve të tjera përkatëse në fuqi. Kodi i Etikës dhe Sjelljes përbën dokumentin bazë që rregullon veprimtarinë e punonjësve të shoqërisë, duke promovuar një kulturë korporative të bazuar në integritet, transparencë dhe trajtim të barabartë të të gjithë pjesëmarrësve në tregun e gazit.
 5. Përbushja e detyrimeve kontraktuale përbën një prioritet për ALBGASZ. Për të garantuar paanshmërinë dhe transparencën, shoqëria ka vendosur një sistem për pranimin dhe trajtimin e ankesave, i cili monitorohet drejtpërdrejt nga Zyrtari i Përputhshmërisë (Compliance Officer) ose nga mekanizmi i sinjalizimit (Whistleblower), me qëllim sigurimin e një trajtimi të drejtë dhe transparent të çdo rasti.
 6. Plani i trajnimeve të realizuara ka pasur si qëllim rritjen e njohurive të stafit mbi detyrimet që rrjedhin nga Programi i Përputhshmërisë, duke minimizuar mundësinë e shkeljeve të paqëllimshme të rregullave të tregut.
 7. Shumë nga pikat e kërkuara, konkretisht pikat 1, 2, 5 dhe 9, lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e përgjithshëm të shoqërisë ALBGASZ. Zyrtari i Përputhshmërisë (Compliance Officer) do të vijojë të raportojë dhe monitorojë elementët që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në pavarësinë, transparencën dhe funksionimin e drejtë të tregut të gazit. Siç përcaktohet edhe në Programin e Përputhshmërisë të miratuar nga ERE. ALBGASZ duhet të angazhohet që, përmes strukturave të saj administrative dhe monitorimit teknik të proceseve përkatëse, të operojë si një subjekt i pavarur, duke garantuar transparencë dhe përgjegjshmëri në sektorin e gazit natyror në Shqipëri.

14. BASHKËPUNIMI ME ERE-N

Ky raportim ka për qëllim të ofrojë një përmbledhje të plotë të bashkëpunimit dhe korrespondencës midis ALBGASZ Sh.a., Zyrtarit të Përputhshmërisë dhe Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në kuadër të zbatimit të Programit të Përputhshmërisë dhe detyrimeve ligjore për sektorin e gazit natyror.

Ky bashkëpunim i gjërë ka filluar me Më 21.01.2025, ERE ka dërguar një shkresë zyrtare (Nr. prot. 216) drejtuar Zyrtarit të Përputhshmërisë, ku konfirmon se raporti vjetor i përputhshmërisë për vitin 2024 është dorëzuar brenda afateve të përcaktuara dhe kërkon informacione shtesë dhe shpjegime për periudhën pasuese. Dhe vijon me vitin 2026 me shkresën e dërguar nga ERE datë, 18.02.2026 nr. 371.1 me titull : Rekomandimet e ERE mbi vlerësimin e Raportit vjetor.

Në vijim, për t'u përgjigjur kërkesave të ngritura nga ERE, paraqiten elementët kryesorë sipas pikave më poshtë:

a) Statusi ligjor dhe struktura e ALBGASZ sh.a.

Këshilli Mbikëqyrës i ALBGASZ, me Vendimin nr. 32, datë 24.06.2024, ka miratuar ndryshimin e organigramës së shoqërisë, duke kryer shtesa dhe ristrukturime për të optimizuar menaxhimin e operimeve në sistemin kombëtar të gazit.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

Në organigramën e re janë përfshirë drejtori dhe sektorë të rinj me fokus në:

- Operimin e rrjetit të gazit në përputhje me standardet teknike dhe të sigurisë;
- Analizën dhe përpunimin e të dhënave operative për presionet, rrjedhat dhe cilësinë e furnizimit;
- Monitorimin e zbatimit të kodeve dhe marrëdhënieve rregullatore me ERE-në dhe operatorët e tjerë të tregut.

Këto ndryshime nuk kanë sjellë rritje të numrit total të punonjësve, por kanë përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet strukturave dhe kanë rritur efikasitetin në menaxhimin e rrjetit.

Shoqëria informon Zyrtarin e Përputhshmërisë me dokumentacionin përkatës që dëshmon respektimin e kërkesave për pavarësinë e operatorit financiar, në përputhje me kushtet e përcaktuara në vendimin e autorizimit. Kjo përfshin edhe një deklaratë zyrtare që konfirmon se operatori financiar nuk është i përfshirë në aktivitetet e prodhimit ose furnizimit me gaz natyror dhe nuk ushtron kontroll apo ndikim mbi ndërmarrje që kryejnë këto aktivitete.

Shoqëria dokumenton çdo ndryshim në strukturën organizative, përfshirë edhe ndryshimet në nivelet drejtuese dhe përgjegjëse. Gjithashtu, duhet të sigurojë që Zyrtari i Përputhshmërisë të ketë akses dhe të njohet në kohë për aktet rregullatore dhe dokumentacionin përkatës, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Programi i Përputhshmërisë.

b) Ndarja dhe pavarësia e ALBGAS sh.a

Në përputhje me pikat 4 dhe 5 të Programit të Përputhshmërisë, janë plotësuar deklaratat përkatëse nga administratori i ALBGAS, ku theksohet se: ALBGAS gëzon autonomi të plotë organizative dhe vendimmarrëse, të ndarë nga çdo strukturë e integruar;

- Asnjë nga drejtuesit e ALBGAS nuk merr pjesë në organet vendimmarrëse të subjekteve të tjera të grupit;
- Nuk përfitohen kompensime financiare nga shoqëri të tjera;
- Pagesat e stafit të ALBGAS nuk lidhen me performancën financiare të subjekteve të tjera.

Këto deklaratat janë pjesë integrale e zbatimit të ndarjes ligjore dhe funksionale, në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe direktivave të BE-së për sektorin e gazit.

c) Përfshirja dhe shpjegimi i diskriminues

ALBGAS publikon rregullisht, janë të përditësuara dhe të aksesueshme në faqen zyrtare ALBGAS, vendimet e ERE-s përsa i përket tarifave dhe akteve rregullatore.

d) Politika e informacionit të ALBGAS sh.a

Shoqëria zbaton detyrimet për publikimin dhe aksesimin e informacionit në përputhje me kërkesat e programeve dhe rregulloreve përkatëse, duke garantuar që informacioni i detyrueshëm për përdoruesit e sistemit dhe palët e interesuara të jetë i publikuar, i përditësuar dhe lehtësisht i aksesueshëm në faqen zyrtare të shoqërisë. Ky informacion duhet të përfshijë përshkrimin e shërbimeve, kushtet dhe procedurat për përfitimin e tyre, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për funksionimin transparent të tregut.

Raporti Vjetor i Përputhshmërisë – 2025

ALBGAZ ka të përfshirë në kontratat e punonjësve dispozita të qarta mbi ruajtjen e informacionit konfidencial, si dhe përcaktimin e përgjegjësisë dhe pasojave ligjore apo financiare në rast të mosrespektimit të këtyre detyrimeve.

Shoqëria siguron publikimin e informacionit të qartë dhe lehtësisht të aksesueshëm për përdoruesit e sistemit dhe palët e interesuara, duke përfshirë listën e shërbimeve të ofruara, kushtet përkatëse dhe procedurat për përfitimin e tyre.

e) Zbatimi i Programit të përputhshmërisë

Shoqëria siguron zbatimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të Programit të Përputhshmërisë në të gjitha strukturat dhe nivelet organizative, duke garantuar respektimin e rregullave dhe procedurave përkatëse në funksion të transparencës dhe integritetit institucional.

Shoqëria siguron njoftimin paraprak dhe në kohë të Zyrtarit të Përputhshmërisë për çdo mbledhje të organeve drejtuese ku trajtohen çështje që lidhen me zbatimin e Programit të Përputhshmërisë. Për këtë qëllim, i vihet në dispozicion rendi i ditës, materialet shoqëruese dhe vendimet përkatëse, si dhe dokumentohet njoftimi dhe pjesëmarrja e tij për qëllime shqyrtimi dhe monitorimi.

Shoqëria bashkëpunon me Zyrtarin e Përputhshmërisë, duke garantuar akses të plotë në strukturat përkatëse dhe në informacionin e nevojshëm për ushtrimin e detyrave të tij, si dhe duke vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës për monitorimin dhe zbatimin e Programit të Përputhshmërisë.

PJESA E TRETË

15.KONKLUZIONE

Viti 2025 shënon vitin e tetë të zbatimit të Programit të Përputhshmërisë nga ALBGAS. Gjatë kësaj periudhe, shoqëria ka vazhduar të konsolidojë praktikën e saj të brendshme për të garantuar respektimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, si dhe për të forcuar parimet e transparencës, pavarësisë dhe trajtimit të barabartë të të gjithë përdoruesve të sistemit.

Nga monitorimi i kryer gjatë këtij viti rezulton se aktiviteti i shoqërisë është zhvilluar në përputhje me kërkesat e Programit të Përputhshmërisë dhe nuk janë evidentuar shkelje të rëndësishme që mund të cenonin funksionimin e pavarur të operatorit të sistemit. Përkundrazi, është vërejtur një përmirësim i vazhdueshëm në mënyrën e zbatimit të procedurave të brendshme dhe në ndërgjegjësimin e stafit mbi detyrimet që rrjedhin nga ky program.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është forcuar bashkëpunimi dhe komunikimi institucional me autoritetin rregullator, çka ka kontribuar në një proces më efikas të monitorimit dhe raportimit të përputhshmërisë. Ky bashkëpunim ka ndihmuar në krijimin e një qasjeje më të strukturuar dhe më të qëndrueshme në menaxhimin e çështjeve që lidhen me zbatimin e rregullave të tregut të gazit natyror.

Në përgjithësi, ALBGAS ka demonstruar stabilitet institucional dhe përkushtim në respektimin e detyrimeve të saj si operator i pavarur i sistemit. Vijimi i forcimit të mekanizmave të brendshëm të kontrollit, rritja e ndërgjegjësimit të stafit dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me autoritetin rregullator mbeten elementë kyç për përmirësimin e mëtejshëm të standardeve të përputhshmërisë në vitet në vijim.

Tiranë, 2026

Elvis Ponari, MBA, MSc

Zyrtari i Përputhshmërisë, ALBGAS Sh.a

